



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Shkup, 20 shtator 2024

Njoftim për shtyp

Zhvillimet monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: gusht, 2024

- **Paraja e gjerë (agregati monetar M3^{1,2})**, në gusht 2024, shënoi rritje mujore prej 1,5%, për shkak të rritjes së parave të depozituara, depozitave afatshkurtra dhe depozitave afatgjata deri në dy vjet, a në pjesë më të vogël nga paratë e gatshme në qarkullim. Rritja vjetore nga 7,4% kryesisht është për shkak të parave të depozituara më të larta, ndërsa kontribut pozitiv kanë edhe depozitat afatgjata deri në dy vjet dhe paratë e gatshme në qarkullim, ndërsa depozitat afatshkurtra kanë shënuar rënie.
- **Totali i depozitave³**, në gusht, shënoi rritje prej 1,9% si rezultat i rritjes së depozitave të të dy sektorëve, me kontribut më të theksuar në rritjen e depozitave të sektorit korporativ. Në nivel vjetor, totali i depozitave shënoi rritje prej 9,1%, që vjen si pasojë e rritjes së depozitave të të dy sektorëve, me kontribut dukshëm më të lartë të sektorit të "amvisërisë".

Tabela 1. Paraja e gjerë dhe totali i depozitave të sektorit joqeveritar

	gjendja (në milionë denarë)				ndryshimet vjetore (në %)				ndryshimet mujore (në %)			
	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024
Paraja e gjerë M4	595,151	591,336	607,881	621,179	8.7	9.5	7.6	9.2	4.3	-0.7	0.5	1.5
Paraja e gjerë M3	529,264	521,804	535,985	546,336	5.9	6.6	5.4	7.4	4.5	-0.9	0.4	1.5
<i>nga të cilat:</i>												
<i>Paratë në qarkullim</i>	50,002	49,336	51,377	53,049	5.3	8.6	7.6	11.5	7.5	1.5	2.2	0.6
<i>Depozitat e parave</i>	211,402	202,074	211,126	214,718	12.4	11.4	8.8	11.8	10.0	-1.9	0.3	1.4
<i>Depozitat afatshkurta</i>	215,860	215,551	215,501	218,046	0.6	1.0	0.1	-0.3	-0.5	-1.1	0.2	1.2
<i>Depozitat afatshkurta deri në 2 vjet</i>	51,999	54,842	57,981	60,523	4.5	10.8	12.7	20.1	2.1	1.4	0.0	3.6
Totali i depozitave	534,241	531,140	544,683	557,764	8.7	9.3	7.2	9.1	4.0	-0.9	0.4	1.9
<i>nga të cilat:</i>												
<i>Sektori korporativ</i>	161,432	150,674	153,830	158,878	13.2	12.2	4.7	3.8	6.6	-2.4	1.0	3.1
<i>Në denarë</i>	109,266	100,009	103,684	106,847	15.8	12.5	5.6	5.7	8.5	-3.6	1.7	3.7
<i>Në valutë të huaj</i>	52,166	50,664	50,146	52,032	8.2	11.4	2.8	0.1	2.7	0.1	-0.4	1.7
<i>Amvisëritë</i>	348,745	354,741	364,432	371,675	7.9	8.7	8.9	12.0	3.5	0.1	0.0	1.2
<i>Në denarë</i>	173,543	177,631	184,627	190,570	11.8	13.7	13.1	19.9	6.4	0.6	-0.6	1.9
<i>Në valutë të huaj</i>	175,201	177,109	179,805	181,106	4.4	4.0	4.8	4.8	0.7	-0.3	0.5	0.6

Burimi: BPRMV.

¹ Duke filluar nga qershori 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si përkufizim i ri standard për paranë e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetar M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.

² Agregatin monetar M1 e përbëjnë paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat pa afat. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati M1 bashkë me depozitat afatshkurtra, ndërsa agregati monetare M3 (paraja e gjerë), përveç agregatit monetar M2 i përfshin edhe depozitat me maturitet nga një deri në dy vjet. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 përbëhet prej agregatit monetar M3 dhe depozitat afatgjate me maturitet mbi dy vjet. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë: <https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20 monetarna 07 2021 al.pdf>

³ Totalin e depozitave e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshirë në agregatin monetare M4, të cilat i takojnë sektorit korporativ, amvisërive, institucioneve tjera financiare, institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive dhe vetëqevirsjes lokale.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- **Totali i kredive**, në gusht, u rrit në bazë mujore me 0,5%, me rritje vjetore prej 7,5%. Rritja është rezultat i rritjes së kreditimit në dy sektoret, me kontribut më të shprehur të kredive të sektorit korporativ.


Tabela 2. Totali i kredive në sektorin joqeveritar

	gjendja (në milionë denarë)				ndryshimet vjetore (so %)				ndryshimet mujore (në %)			
	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024
Totali i kredive	444,721	449,251	462,435	467,411	5.1	6.1	6.4	7.5	1.3	0.3	0.8	0.5
<i>nga të cilat:</i>												
Sektori korporativ	212,768	214,268	221,765	224,112	3.3	5.4	5.8	8.1	2.2	0.0	0.6	0.5
Në denarë	131,089	134,280	144,110	148,442	7.1	11.9	16.2	19.8	2.7	1.0	2.6	1.7
Në valutë të huaj	81,679	79,988	77,656	75,670	-2.3	-3.9	-9.3	-9.3	1.4	-1.7	-2.8	-1.6
Amvisëritë	229,404	232,313	238,057	240,911	6.7	6.8	7.1	7.2	0.5	0.5	1.0	0.4
Në denarë	125,223	126,809	130,453	132,110	5.1	5.8	7.2	7.0	0.0	0.3	1.2	0.3
Në valutë të huaj	104,180	105,504	107,603	108,802	8.8	8.1	7.0	7.4	1.2	0.6	0.7	0.6


Burimi: BPRMV.



Burimi: BPRMV.



1. Depozitat dhe kreditë e sektorit korporativ⁴





Burimi: BPRMV.

⁴ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin kompanitë publike dhe private jofinanciare.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- Totali i **depozitave të sektorit korporativ**, në gusht, shënoi rritje prej 3,1% në bazë mujore. Ndërkaq, ndryshimi mujor është kryesisht rezultat i rritjes së parave të depozituara dhe depozitave afatshkurtra në denarë dhe në valutë të huaj, ndërsa ndikim më të vogël pozitiv kanë depozitat afatgjata në denarë, ndërkohë që depozitat afatgjata në valutë të huaj kanë shënuar rënie. Në nivel vjetor, rritja është 3,8%, në pjesën më të madhe për shkak të rritjes së parave të depozituara, depozitave afatgjata në valutë të huaj dhe depozitave afatshkurtra në denarë, me kontribut shtesë edhe të depozitave afatgjata në denarë, ndërsa depozitat afatshkurtra në valutë të huaj shënuan rënie.
- Në gusht, **kreditë e sektorit korporativ**⁵ shënuan rritje mujore dhe vjetore prej 0,5%, respektivisht 8,1%, që në tërësi është si pasojë e rritjes së kreditimit në denarë, ndërsa kreditimi në valutë të huaj është ulur.



Burimi: BPRMV.

2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive⁶



Burimi: BPRMV.



⁵ Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj.

⁶ Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe të ekzekutuesve të pavarur të veprimtarisë.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- Në gusht, në **totalin e depozitave të amvisërive** është shënuar rritje mujore dhe vjetore prej 1,2% përkatësisht 12,0%. Ndryshimi në të dyja bazat, që është kryesisht për shkak të rritjes së parave të depozituara, si dhe depozitave afatgjata në valutë të huaj dhe denarë, në kushtet e rënies së depozitave afatshkurtra në valutë të huaj dhe në denarë.
- Kreditë e amvisërive**, në gusht, janë më të larta për 0,4% krahasuar me muajin e kaluar. Analizuar sipas valutës, rritja mujore rezulton nga rritja e kreditimit në denarë dhe në valutë të huaj, me kontribut më të theksuar të kredive në valutë të huaj. Rritja vjetore prej 7,2% është rezultat i kredive më të larta në denarë dhe në valutë të huaj, me kontribut më të theksuar të kredive në denarë.



Burimi: BPRMV.



Burimi: BPRMV.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Tabela 2. Kreditë e bankave dhe kursimoreve të dhëna për personat fizikë, sipas qëllimit

	gjendja (në milionë denarë)				ndryshimet vjetore (në %)				ndryshimet mujore (në %)			
	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024
Kreditë konsumatore	119,868	119,858	122,818	124,370	6.5	5.8	5.8	6.4	1.1	0.4	0.8	0.3
Kreditë për banesa	83,891	85,555	87,920	89,278	10.5	10.4	10.2	10.8	1.4	1.0	0.9	0.8
Kreditë për automjete	399	399	458	490	11.4	13.1	25.3	27.4	2.7	1.8	7.5	4.5
Kartat e kreditit	9,835	9,459	9,332	9,258	-4.7	-6.8	-8.0	-8.9	-1.9	-0.8	-0.3	-0.6
Bilancet negative të llogarive rrjedhëse	6,000	6,820	6,846	6,555	0.6	6.1	7.9	-7.3	-13.8	2.3	5.7	-3.3
Kreditë e miratuara mbi baza të tjera	1,782	1,658	1,579	1,552	-19.3	-21.2	-18.8	-19.5	-2.5	-1.7	-2.0	-1.7

Burimi: BPRMV.

- Në gusht 2024, analizuar sipas qëllimit të kredive të miratuara për personat fizikë, **te kreditë konsumatore dhe banesore**, si kategori më të përfaqësuar, shënuan rritje mujore prej 0,3% përkatësisht 0,8%, me rritje vjetore prej 6,4% përkatësisht 10,8%. **Kreditë për automjete**, këtë muaj, shënojnë rritje për 4,5% përkatësisht 27,4%. Kreditë e miratuara për **kartelat kreditore** janë më të ulëta për 0,6% dhe 8,9%, në baza mujore dhe vjetore, ndërsa **bilancet negative të llogarive rrjedhëse** shënuan rënie mujore dhe vjetore prej 3,3% përkatësisht 7,3%. Në gusht, kreditë e miratuara **në baza tjera**, u ulën në baza mujore dhe vjetore për 1,7% përkatësisht 19,5%.

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: Balance dhe pasqyra të institucioneve depozituese, të dhëna mujore: https://www.nbrm.mk/monetarna_statistika-al.nspj

Shpjegime metodologjike:

[Metodologjia monetarna 07 2021 al.pdf](https://www.nbrm.mk/monetarna_07_2021_al.pdf) (nbrm.mk)

Informacioni për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesi: https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

http://nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: 21 tetor 2024 (mesatare referuese, përfshirë shtatorin e vitit 2024).

Për pyetje të gazetarëve, Ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02/3215-235 lok. 108/110.